



REPUBLIKA E SHQIPËRIË
MINISTRIA E BRENDSHME



RAPORT

JANAR – QERSHOR

2023



MINISTRIA E BRENDSHME

QENDRA E KOORDINIMIT KUNDËR EKSTREMIZMIT TË DHUNSHËM

info@cve.gov.al

www.cve.gov.al

***Ky raport përmbledh veprimtarinë e kryer nga institucioni gjatë periudhës Janar-Qershor 2023.**

PËRMBAJTJA

SHKURTESA	3
1. PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME	4
2. ZBATIMI I PLANIT TË RI-INTEGRIMIT	8
3. AKTIVITETE INFORMIMI, NDËRGJEGJËSIMI DHE RRITJA E KAPACITETEVE	13
4. KOMUNIKIMI STRATEGJIK	17
5. BASHKËPUNIME ME PARTNERË NË NIVEL KOMBËTAR, RAJONAL, NDËRKOMBËTAR	18
6. AKTIVITETI RAPORTUES DHE MONITORUES	26
7. PROBLEMATIKA	28

SHKURTESA

Qendra e Koordinimit kundër Ekstremizmit të Dhunshëm	QKEDH
Parandalimi dhe Kundërshtimi i Ekstremizmit të Dhunshëm	P/KEDH
Strategjia Kombëtare për Luftën Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm	Strategjia Kombëtare
Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	MSHMS
Ministria e Brendshme	MB
Ministria e Mbrojtjes	MM
Ministria e Drejtësisë	MD
Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme	MPEJ
Ministria e Arsimit dhe Sportit	MAS
Organizata Ndërkombëtare për Migracionin	IOM
Fondi Global i Angazhimit dhe Qëndrueshmërisë të Komunitetit	GCERF
Komisioni Evropian	KE
Rehabilitimi , Ri- integrimi dhe Risocializim	R&R&R
Instituti për Aktivizëm dhe Ndryshim Social	IANS
Mekanizmin Koordinues Teknik	MKT
Vendim i Këshillit të Ministrave	VKM
Qendra Pritëse e Trajtimit të Rasteve të Rikthyer nga Siria dhe Iraku	Qendra Pritëse
Luftëtarëve të Huaj Terroristë	LHT
Drejtoria e Përgjithshme të Burgjeve	DPB
Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit	AKSHI
Instituti i Kërkimit të Krimin Ndër-Rajonal dhe të Drejtësisë së	UNICRI
Kombeve të Bashkuara	
Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim	IDM
Qendra për Nisma Ligjore e Qytetare	QNLQ
Organizata të Shoqërisë Civile	OSHC
Drejtoria Antiterrorit	DA
Shërbimi Informativ i Shtetit	SHISH
Njësia Administrative	NJA
Punonjës i Mbrojtjes së Fëmijës	PMF
Terres de Homme	TdH
Woman Center for Development and Culture Albania	WCDCA
Linja e Këshillimit për Gra dhe Vajza	LKGV


1. PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME

Dokumenti në vazhdim është paraqitje e veprimtarive kryesore të Qendrës së Koordinimit kundër Ekstremizmit të Dhunshëm (në vijim QKEDH) për periudhën kohore “Janar-Qershor 2023”, i cili është hartuar duke evidentuar aktivitetet kryesore të kryera bazuar në objektivat institucionale të QKEDH.

Përgjatë pjesës së parë të vitit 2023, QKEDH ka vijuar realizimin e misionit të saj koordinues ndër-institucional në parandalimin dhe kundërshtimin e fenomenit të ekstremizmit të dhunshëm në zbatim të **Strategjinë Ndërsektoriale për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Luftën kundër Terrorizmit 2023–2025** si dhe Planin e Veprimit 2023-2025 të miratuar me VKM Nr.81, date 14.02.2023, si dhe Planin e Përbashkët të Veprimit Kundër Terrorizmit në Ballkanin Perëndimor për vitet 2023-2024 si detyrim i vendit për përbushjen e prioriteteve të përcaktuara për të luftuar terrorizmin me të gjitha format e shfaqjes së tij, si dhe nevoja e implementimit të objektivave që dilnin nga detyrimet ndërkombëtare të miratuara nga Këshilli i Sigurisë i OKB-së, Strategjinë e BE-së kundër terrorizmit dhe Konventën Evropiane dhe Protokollin shtesë të saj për parandalimin e terrorizmit, ku adresohet edhe fenomeni i luftëtarëve të huaj terroristë (LHT).

Ky dokument strategjik përfaqëson një vëmendje të shtuar ndaj parandalimit dhe luftimit të akteve terroriste, parandalimin e kundërshtimin e radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm nëpërmjet krijimit dhe reformimit të komuniteteve dhe institucioneve më të qëndrueshme, rehabilitimin dhe riintegrimin e personave të radikalizuar dhe të kthyer nga zonat e konfliktit dhe familjeve të tyre, zhvillimin e një komunikimi strategjik dhe parandalimin e kundërshtimin e radikalizimit online. Kjo strategji do të shërbejë si instrumenti kryesor për të bashkërenduar ndërveprimin institucional kundër ekstremizmit të dhunshëm dhe terrorizmit.

Në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga VKM (konfidenciale) nr. 453, datë 29/07/2021 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 826, datë 26.10.2020 të Këshillit të Ministrave “Për ofrimin e shërbimeve për pritjen dhe akomodimin e fëmijëve të pashoqëruar të kthyer nga Siria dhe Iraku” dhe VKM nr. 237 dt. 20/04/2022 “ Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin Nr. 737 dt. 13/12/2017 të Këshillit të Ministrave “Për ngritjen e Qendrës së Koordinimit kundër Ekstremizmit të Dhunshëm”, QKEDH vazhdon angazhimin për koordinimin dhe monitorimin e punës me institucionet qendrore, vendore dhe partnerët ndërkombëtarë për proceset e parandalimit të radikalizimit, kundërshtimit të ekstremizmit të dhunshëm dhe pritjes dhe akomodimit të shtetasve të rikthyer nga ish zonat e konfliktit si dhe zbatimin të planeve të rehabilitimit dhe ri-integrimin.



Aktiviteti është fokusuar në zbatimin e veprimtarisë së planifikuar në nivel qendror dhe vendor në bashkëpunim me partnerë/aktorë të ndryshëm të shoqërisë për përmbushjen e objektivave të Planit të Veprimit (P/KEDH) në parandalimin e fenomenit. Ka vijuar zbatimi dhe monitorimi i procesit të ri-integrimit të 37(tridhjetë e shtatë) personave të riadhesuar nga këto kampe, konkretisht për 13 (trembëdhjetë) shtetasve shqiptarë që u riadhesuan më datë **27 maj 2022**, 19 (nëntëmbëdhjetë) shtetasve shqiptarë të riadhesuar më datën **1 gusht 2021** dhe 5(pesë) shtetasve shqiptarë të riadhesuar në **27 tetor 2020** si dhe realizimin e objektivave të Planit të Veprimit P/KEDH. Gjatë periudhës referuese, në **6-mujorin e parë të vitit 2023, janë kryer aktivitete të rëndësishme dhe për zhvillimin e Komunikimit Strategjik që është një prej tre objektivave sfidues të P/CVE.**

QKEDH ka promovuar dhe mbështetur rolin e shoqërisë civile në zbatimin e plotë të veprimit të P/KEDH-së në koordinim me institucionet e linjës. Ka kontribuar me ide–propozimet e kërkuara në kuadër të zbatimit të P/KEDH me qëllim tërheqjen e granteve¹ të publikuara nga donatorët mbështetës të Qeverisë Shqiptare në fushën e P/KEDH në mbështetjen dhe promovimin e OSHC-ve shqiptare në kuadër të idesë së partnershipit publik-privat për forcimin e rolit të tyre, si dhe në marrjen e fondeve të akorduara nga organizata ndërkombëtare GCERF me qëllim kontributin dhe

¹Referuar raporteve të Organizatave të Shoqërisë Civile lidhur me grantet e akorduara nga Ambasada e SHBA-ve dhe GCERF.

impenjimin e OSHC-ve në përfitimin e fondeve të konsiderueshme ndërkombëtare në kuadër të zbatimit të P/QKEDH në Shqipëri.

Në përmbushje të objektivave të Planit të Veprimit, QKEDH ka koordinuar dhe ka marrë pjesë në 119(njëqind e nëntëmbëdhjetë) sesione trajnimi/forume/ takime informuese/workshop/webinare online dhe bashkëpunime për ngritje kapacitetesh për strukturat e përfshira drejtpërdrejtë dhe trajnime si në nivelin qendror, ashtu dhe në nivelin vendor të lidhura me parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe procesin e ri-integrimit.

Gjatë 6-mujorit të parë të këtij viti, dinamika e aktivitetit u fokusua në zbatimin e veprimtarisë së planifikuar në nivel qendror dhe vendor në bashkëpunim me partnerët apo aktorët e ndryshëm të shoqërisë për përmbushjen e objektivave të Planit të Veprimit, si dhe procesit të rehabilitimit dhe riintegritimit të të gjithë shtetasve të riatdhesuar gjatë tre misionëve të riatdhesimit dhe atyre që pritet të rikthehen në vijim. Ky aktivitet përfshin:

- Pas miratimit të **Strategjisë Ndërsektoriale për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Luftën kundër Terrorizmit 2023–2025** dhe Planit të Veprimit 2023-2025 të miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr.81, date 14.02.2023 ka vijuar me zbatimin e masave për parandalimin e këtij fenomeni;
- Koordinimin e të gjithë strukturave shtetërore dhe organizatave të përfshira për riintegrimin dhe risocializimin në komunitet të 37 (tridhjetë e shtatë) shtetasve të rikthyer, konkretisht, 27 (njëzet e shtatë) fëmijë dhe 10 (dhjetë) gra;
- Promovimin dhe mbështetjen e rolit të shoqërisë civile në zbatimin e plotë të veprimit të P/KEDH-së në koordinim me institucionet e linjës;
- Koordinimin e punës dhe orientimin e partnerëve kombëtarë dhe ndërkombëtarë, mbështetës të procesit të rehabilitimit, ri-integrimit dhe të risocializimit (RRR) të shtetasve të kthyer;
- Nxitjen e kontributit me ide–propozimet e kërkuara QKEDH-së, në kuadër të zbatimit të P/KEDH me qëllim tërheqjen e granteve të vogla të publikuara nga donatorët mbështetës të Qeverisë Shqiptare në fushën e P/KEDH; (Ref. OSHC-ve, lidhur me grantet e akorduara nga Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, etj.);
- Mbështetjen dhe promovimin e OSHC-ve shqiptare në kuadër të idesë së partneritetit publik-privat me qëllim forcimin e rolit të tyre, por edhe thithjen e fondeve të akorduara nga organizata ndërkombëtare GCERF, me qëllim kontributin dhe impenjimin e OSHC-ve për të përfituar mbështetje të konsiderueshme ndërkombëtare në kuadër të objektivave dhe zbatimit të aktiviteteve të P/KEDH në Shqipëri.

Përgjatë periudhës raportuese, QKEDH ka filluar punën për implementimin e Planit të Përbashkët të Veprimit Kundër Terrorizmit në Ballkanin Perëndimor, ku janë përcaktuar masat prioritare të

QKEDH për vitet 2023-2024 në parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe luftën kundër terrorizmit.

Në vijim të zbatimit të planit të veprimit, QKEDH ka hartuar dhe ka përcjellë për miratim pranë Ministrisë të Brendshme “**Procedurën Standarde të Veprimit**” për rehabilitimin dhe riintegrimin fillestar të personave të kthyer nga zonat e konfliktit Siri-Irak. Ky dokument standard veprimi është rishikuar nga të gjitha institucionet përkatëse, në të cilin janë finalizuar të gjitha reflektimet e komenteve të institucioneve sipas referimeve shkresore dhe është dërguar pranë departamentit përkatës dhe jemi në pritje të miratimit të tij.

QKEDH në kuadër të bashkëpunimit me GCERF pasi Qeveria Shqiptare u bë pjesë e Bordit të GCERF, krijoi për here të parë, “Mekanizmin Koordinues Teknik” në Janar 2023, për koordinimin dhe monitorimin e ndërhyrjeve të GCERF në vendin tonë.

Në periudhën e mëparshme të granteve, Shqipëria ka përfituar nga fondi i GCERF në nivel rajonal, pasi financimi i WB6 nuk kërkonte një mekanizëm teknik me bazë vendi për koordinim. Takimi i parë ku të gjithë aktorët e përfshirë në MKT prodhuan inpute shumë të vlefshme për Strategjinë e vendit që po përgatit GCERF. Një nga sfidat e këtij mekanizmi është edhe diversifikimi i palëve të interesit, identifikimi i sektorëve, ministritë e linjës dhe bashkia përbënte një sfidë për MKT, veçanërisht në nivel qeveritar. Duke marrë parasysh ndryshimet institucionale, reformën dhe politikën e P/KEDH sfidë do të jetë vëzhgimi i përfaqësuesve dhe roleve të anëtareve pasi të gjithë duhet të njohin qëllimin e granteve dhe prioritetet specifike të vendit në lidhje me P/KEDH.

Gjithashtu, QKEDH me mbështetjen e GCERF, ka propozuar dhe ka filluar puna për ngritjen e një qendre multidisiplinore në Tiranë për ofrimin e shërbimeve për fëmijët dhe familjet viktimë të ekstremizmit të dhunshëm.

QKEDH gjatë kësaj periudhe ka përfunduar fazën e përgatitjes dhe pritet të miratohet një **urdhër “Për krijimin e komitetit rajonal të parandalimit të radikalizmit dhe luftës kundër ekstremizmit të dhunshëm”**, i cili do të shërbejë si mekanizëm kombëtar referimi, pasi një mekanizëm i tillë mungon duke sjellë vështirësi dhe pamundësi të evidentimit të rasteve dhe fenomeneve radikale në kohën e duhur.

Në kuadër të ngritjes së sistemit të bazës së të dhënave për menaxhimin e informacionit (sistemi ICRS), databazë elektronike për personat e kthyer nga ish zonat e konfliktit Siri dhe Irak, ka përfunduar faza e vlerësimit teknik si dhe atij ligjor. QKEDH-ja është koordinuar me Komisionerin për Mbrojtjen e të dhënave si dhe AKSHI-n, në çdo fazë të përpilimit të këtij sistemi. Parashikohet

që ky sistem, i cili është mbështetur nga organizata IOM, të implementohet në 6-mujorin e ardhshëm.

QKEDH në koordinim me Punonjësit e Mbrojtjes së Fëmijëve të NJA përkatëse, psikologë dhe përfaqësues të Shërbimit Ligjor Falas (TLAS), Drejtorisë së Antiterrorit dhe strukturave të Policimit në Komunitet, Rrjetin e Mësuesve Koordinatorë në nivel Kombëtar, Organizatat e Shoqërisë Civile, ka identifikuar dhe bashkërenduar punën për trajtimin e çështjeve që lidhen me radikalizmin, ekstremizmin e dhunshëm si dhe shfaqjen e fenomeneve të reja që janë hasur te personat e rikthyer nga ish zonat e konfliktit Siri dhe Irak, si në fazën e rehabilitimit ashtu edhe në atë të riintegritimit në komunitet.

Gjatë 6-mujorit të parë të vitit 2023, QKEDH ka kryer takime me Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve **për ngritjen e një sistemi të menaxhimit të të dhënave për individët me prirje radikale ekstremiste apo terroriste.**

QKEDH ka nxitur angazhimin e institucioneve kompetente shtetërore dhe rritjen e kapaciteteve njerëzore, rritjen e shkëmbimit të informacionit dhe aksesueshmërisë së tij si dhe rritjen e bashkëpunimit ndërinstytucional. Gjatë periudhës raportuese është përmirësuar bashkëpunimi ndërsektorial mes strukturave që koordinojnë realizimin e masave në zbatim të planit të veprimit.

2. ZBATIMI I PLANIT TË RIINTEGRIMIT

QKEDH ka vijuar me realizimin e veprimtarisë së masave të planifikuara për të përmbushur objektivat e Planit të Veprimit në zbatim të **Strategjinë Ndërsektoriale për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Luftën kundër Terrorizmit 2023–2025** të miratuar me VKM Nr.81, date 14.02.2023, me fokus të veçantë në procesin e rehabilitim-riintegritimit të të gjithë shtetasve shqiptar të riatdhesuar nga ish zonat e konfliktit Siri dhe Irak.

Lidhur me rastet e identifikuar dhe të raportuara ndaj institucioneve të ngarkuar me zbatimin e VKM (konfidenciale) nr. 453, datë 29/07/2021 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 826, datë 26.10.2020 të Këshillit të Ministrave “Për ofrimin e shërbimeve për pritjen dhe akomodimin e fëmijëve të pashoqëruar të kthyer nga Siria dhe Iraku”, QKEDH ka vijuar aktivitetin e grumbullimit të informacioneve, raporteve dhe koordinimin mbi zbatimin e procesit të riintegritimit të 13 (trembëdhjetë) shtetasve shqiptarë që u riatdhesuan me datë 27 maj 2022, 19 (nëntëmbëdhjetë) shtetasve shqiptarë që u riatdhesuan më datën 1 Gusht 2021, si dhe të 5 (pesë) shtetasve të riatdhesuar në 27 tetor 2020 nga vendet e konfliktit (Siri dhe Irak). Gjithashtu vazhdon mbështetja psikologjike dhe marrja e raporteve për target - grupin e të kthyerve para vitit 2014, në Bashkinë Cërrik.

Në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga VKM (konfidenciale) nr. 453, datë 29/07/2021 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 826, datë 26.10.2020 të Këshillit të Ministrave “Për ofrimin e shërbimeve për pritjen dhe akomodimin e fëmijëve të pashoqëruar të kthyer nga Siria dhe Iraku” për 37 (tridhjetë e shtatë) shtetas të riatdhesuar, QKEDH në bashkërendim me institucionet përkatëse ka vijuar me koordinimin e aktiviteteve dhe shërbimeve të cilat zhvillohen në kuadër të zbatimit të procesit të ri-integrimit të tyre pas vendosjes në komunitet.

Për zbatimin e planit të riintegrit, përgjatë 6-mujorit të parë, QKEDH-ja ka koordinuar dhe zhvilluar **32 (tridhjetë e dy) takime të Grupeve Teknike Ndër-sektoriale (GTN) të ngritura për të 12 (dymbëdhjetë) familjet e rikthyera nga ish zonat e konfliktit Siri-Irak** ku u diskutua mbi monitorimin, përmirësimin dhe problematikat që këto raste kanë reflektuar gjatë kësaj periudhe bazuar në **Planet Individuale të Mbrojtjes (PIM) ngritur për këto familje (veçanërisht fëmijët), si dhe hapat e ndërmarra mbi integrimin e tyre në komunitet.**

QKEDH ka zhvilluar takime me përfaqësues të Bashkisë Tiranë (Njësia e Mbrojtjes së Fëmijëve) në lidhje me koordinimin e mëtejshëm ndërmjet PMF-ve dhe QKEDH-së në mbarëvajtjen e procesit të riintegrit të fëmijëve të rikthyer nga zonat e ish konfliktit Siri-Irak.

Theksohet se përgjatë periudhës raportuese QKEDH-ja koordinoi me PMF-në që menaxhon familjen e të riatdhesuarës F.R një **takim urgjent jashtë rutinës së PIM për arsyen e ndërrimit të shtëpisë së rastit ku nga NJA 7 ka kaluar në territorin e NJA 11** ku u evidentuan një sërë problematikash në lidhje me rastin F.R. Transferimi i vendndodhjes së familjes së F.R gjatë muajit prill pa dijeninë e asnjërës prej strukturave apo aktorëve që janë të përfshirë në ofrimin e shërbimeve ndaj rastit, solli probleme për shkak të ndryshimit urgjent të menaxheres së rastit, shpenzimeve në lidhje me qiranë dhe faturat për muajin përkatës. Për arsye të transferimit të banesës, dy vajzat e mitura pësuan shpërngulje nga kopshti i mëparshëm dhe nuk janë akomoduar ende në një kopsht afër banesës aktuale, në shtator do të bëhet transferimi në kopshtin që ndodhet pranë banesës së tyre. QKEDH u koordinua me të gjithë aktorët e përfshirë në proces për mbarëvajtjes dhe normalizimin e procesit të riintegrit të kësaj familjeje.

Lidhur me procesin e riintegrit që po zbatohet me fëmijët e rikthyer nga ish zonat e konflikt, të 22 (njëzet e dy) fëmijët që janë në moshë shkollore, kanë ndjekur procesin mësimor në vitin akademik 2022-2023 pranë institucioneve shtetërore sipas vendosjes në NjA ku jetojnë, gjithashtu të gjithë fëmijët janë ndjekur me Plane Individuale (P.I) të hartuara nga MAS si dhe ato të mësuesve mbështetës të kontraktuar nga bashkëpunëtorët e QKEDH-së për të koordinuar këtë

proces², lehtësuar procesin mësimor dhe krijuar e kushtet e përshtatshme për riintegrimin mësimor të tyre.

QKEDH koordinoi me Punonjësit e Mbrojtjes së Fëmijëve **10 (dhjetë) takime GTN** për 8 (tetë) prej fëmijëve të rikthyer nga ish zonat e konfliktit, të cilët përfunduan klasën e IX në ciklin e detyrueshëm bazë parauniversitar. Në këto takime morën pjesë familjarë të rasteve, përfaqësues të Zyrës Vendore Arsimore, psikologëve të shkollave, mësuesve mbështetës, psikologëve që mbështesin fëmijët, me qëllim diskutimin dhe parashtrimin e të gjithave mundësive për përcaktimin e vazhdimësisë së sistemit parauniversitar ku 7 (shtatë) prej tyre do të ndjekin në vazhdim arsimin e mesëm profesional dhe 1 (një) prej fëmijëve do të ndjekë Liceun Artistik të Tiranës për pikturë.

Në vijim, gjatë kësaj periudhe raportimi QKEDH ka bashkërenduar punën me Agjencinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësisimit për vazhdimin e arsimit të mesëm profesional për këta fëmijë. Pas përfundimit me sukses të provimeve kombëtare të ciklit të detyrueshëm bazë, QKEDH po monitoron procesin e mëtejshëm të regjistrimit të tyre nën asistencën e PMF-së që është menaxher rasti për këta fëmijë.

Gjatë pjesës së parë të këtij 6-mujori, QKEDH një rëndësi të veçantë i ka kushtuar problematikës së shfaqur nga 3-(tre) fëmijët e rikthyer gjatë fazës së katërt të riatdhesimeve përse i përket mos ndjekjes së procesit mësimor, kjo për shkak të largimit dhe qëndrimit në ish zonat konfliktit për shumë vite. QKEDH ka bashkëvepruar me PMF-të që menaxhojnë këta të mitur duke koordinuar dhe zhvilluar disa takime me aktorët e përfshirë në proces me qëllim drejtimin dhe ndjekjen e arsimit të detyrueshëm bazë. Ky proces u finalizua me sukses duke përfunduar vitin shkollor të gjithë fëmijët.

Duke iu referuar konkretisht procesit të ri-integrimit që po zbatohet me fëmijët e rikthyer, QKEDH në koordinim me PMF-të dhe organizatat mbështetëse³ mundësuan që 12 (dymbëdhjetë) prej fëmijëve të ndjekin kurse të gjuhëve të huaja (anglisht dhe frëngjisht), gjithashtu u mundësua fillimi dhe ndjekja e kurseve rekreative për 6 (gjashtë) fëmijë, 5 (pesë) djem po ndjekin kurse futbollit dhe 1 (një) vajzë po zhvillon kurs pikturë.

QKEDH ka vijuar me zbatimin e objektivave dhe aktiviteteve në kuadër të Planit të Veprimit, veçanërisht në lidhje me programet e rehabilitimit dhe riintegrimin. Fokusi i QKEDH është

² Konkretisht Linja e Këshillimit për Gra dhe Vajza (LKGv), International Organisation for Migration (IOM), Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM)

³Në vijim të projektit “Riintegrimi i qëndrueshëm në komunitet i shtetasve shqiptarë të kthyer nga Siria”, me mbështetjen e GCERF, ku nëpërmjet Consortium-it WCDA po mundësohet kryerja e kurseve profesionale dhe kurset e gjuhëve të huaja.

fuqizimi ekonomik i grave të kthyer, nëpërmjet aftësimit profesional me qëllim punësimin në të ardhmen, ku 2 (dy) prej grave po ndjekin kurse profesionale (për rrobaqepësi dhe kuzhinë) pranë Drejtorisë Rajonale të Formimit Profesional Publik Nr.1 Tiranë, me mbështetjen e IDM një prej të rikthyer është mbështetur për hapjen e një biznesi nga organizata TdH. Gjithashtu raportohet se 1-(një) prej nënave të riatdhesuara ka përfunduar kursin profesional si operatore për përpunimin e të dhënave në fushën e kontabilitetit pranë një kompanie private. Një tjetër nënë ka shfaqur dëshirën për të ndjekur arsimin e mesëm me qëllim ngritjen e kapaciteteve dhe krijimin e mundësive për punësim në të ardhmen. QKEDH në bashkëpunim me Zyrën Vendore Arsimore po vijon procedurat e regjistrimit të rastit në shkollën e mesme “Kostandin Kristoforidhi”. Vijon procesi për 1 (një) nga nënat e cila do të fillojë të punojë në kushte shtëpie, ku në këtë 6- mujor është mundësuar paisja me artikujt e përshtatshëm për rrobaqepësi. Rasti do të ndiqet dhe asistohet nga PMF e fëmijëve dhe psikologu mbështetës.

Gjatë periudhës raportuese, QKEDH ka vijuar të monitorojë zbatimin e këtij plani dhe të koordinojë për plotësimin e nevojave të identifikuar për këta shtetas. Procesi i riintegritimit ka vijuar normalisht bazuar në Planet Individuale të Mbrojtjes zhvilluar për çdo familje. Për secilin prej rasteve të riatdhesuara nga ish vendet e konfliktit Siri dhe Irak, ka vijuar mbështetja nga organizatat e shoqërisë civile në këtë proces me paketa humanitare periodike, karta me vlerë monetare për të mbuluar nevojat e tyre gjatë muajit⁴, rimbursimin e bonusit të qirasë, pagesës së ujit dhe dritave sipas rasteve që e kanë shfaqur si nevojë, apo dhe për të tjera nevoja të identifikuar. Menaxheri i rastit të NJA Kashar bëri të mundur aplikimin për zhvendosjen e Njësisë Administrative të rastit E.S nga NJA 2 në NJ.A Kashar si dhe asistimin për ndryshimin e mjekut të familjes për këtë rast.

Në pjesën e dytë të këtij 6-mujori, QKEDH koordinoj me PMF-në dhe organizatën TdH në përmbushjen e mobilimit bazë për shtëpinë e rastit S.S (riatdhesuar në datën 27.05.2022), të cilën rasti në fjalë e ka me AKT përdorimi për 10 vite.

QKEDH ka vijuar me koordinimin dhe monitorimin e proceseve të riintegritimit për rastet e të rikthyerve të zonës së Cërrikut. QKEDH ka zhvilluar takime me psikologët mbështetës dhe ka shqyrtuar raportet mujore të psikologëve mbështetës të këtyre familjeve me qëllim identifikimin dhe adresimin e problematikave të hasura në kohë dhe vazhdimin e ofrimit të kësaj mbështetjeje në vazhdim.

Në kuadër të riintegritimit të fëmijëve, QKEDH zhvilloi takim me psikologun e siguruar nga organizata TdH që mbështet tre raste të të miturve (konkretisht A.M, A.K, A.R), ku u diskutua mbi

⁴ Siguruar nga organizatat TdH dhe Linja e Këshillimit për Gra dhe Vajza(LKGV), sipas mbështetjes së ofruar për familje

përparimin dhe problematikat që kanë këto raste dhe për mundësitë që mund të kenë për vazhdimin e arsimit të mesëm (pasi të miturit janë në përfundim të arsimit 9-vjeçar).

Lidhur me procesin e riintegrit të njërit prej të miturve të kthyer gjatë fazës së katërt të riatdhesimeve, QKEDH ka zhvilluar disa takime me të afërmit e tij dhe të gjithë aktorët e përfshirë në proces, për çështjen e marrjes së kujdestarisë së të miturit nga tezja e tij. Për shkak të sigurisë dhe shërbimeve mbështetëse që merr pranë strukturave të Fshatit SOS, është dakordësuar që i mituri të vijojë të akomodohet pranë këtij komuniteti deri në arritjen e moshës madhore 18-vjeç.

Aktiviteti i QKEDH-së është fokusuar në koordinimin me PMF-të përkatëse për identifikimin e nevojave të shtetasve të rikthyer, kryesisht të rikthyerve gjatë riatdhesimit të katërt, të cilët u vendosen në komunitet në periudhën shtator- nëntor 2022 dhe adresimin e problematikave të organizatat mbështetëse⁵. Këto organizata mbështesin të gjitha familjet me plotësimin e nevojave të paraqitura për veshmbathje, mjete didaktike, medikamente paketa humanitare dhe shërbime ekstra në raste nevojash imediate.

Përgjatë 6-mujorit të parë të vitit 2023, QKEDH ka grumbulluar raportimet dhe bashkërendon punën me PMF-të, që janë menaxherë të rasteve dhe vazhdojnë të monitorojnë proceset e zhvilluara për njësitë familjare të këtyre shtetasve. Gjithashtu, bashkërendon punën me psikologët që kanë vazhduar me seancat këshilluese në kuadër të terapisë që zbatohet si për nënat dhe të miturit. Mbështetja psikologjike përfshin aktivitete psiko-sociale, psiko – edukim dhe aplikim të testeve të nevojshme të vlerësimit, zbatimin e teknikave të artit dhe lojës gjatë seancave me fëmijë që ndjekin moshën, vështirësitë dhe zhvillimin përkatës të fëmijës, zbatimin e testeve projektive për të kuptuar problemet rrënjësore dhe për të parë dinamikën e familjes, çështjet e komunikimit dhe ndërveprimin, aplikimi i teknikave me qasje psiko-analitike gjatë seancave individuale me prindërit si dhe aplikimi i teknikave të terapisë në grup me kombinimin e një qasjeje të orientuar drejt familjes. Seancat psikologjike merren 1 deri në 2 herë në javë, në varësi të nevojës së rastit.

Mbështetja teologjike po vazhdon të jepet për dy gra dhe për një nga fëmijët.

QKEDH po vijon koordinimin dhe monitorimin me të gjithë aktorët e përfshirë në proces në mënyrë që procesi i integrit të të kthyerve të zhvillohet në mënyre sa më efektive.

Në përmbushje të të gjithë këtij procesi, është punuar njëkohësisht me shërbimin ligjor i cili është mundësuar nga Tirana Legal Aid Society (TLAS) dhe mbështetur financiarisht nga UNICEF. Ky proces është kompleks dhe dinamik, si për nga natyra sensitive ashtu edhe nga statusi që përfituesit

⁵ Terres de Hommes (TdH) dhe Linja e Këshillimit për Gra dhe Vajza (LKGV)

mbartin që prej largimit të tyre. Gjendja përgjatë periudhës raportuese, që nga rastet e riadhesimit të parë e deri në riadhesimin e fundit është si më poshtë:

Në total janë hapur 37 (tridhjetë e shtatë) çështje ligjore për të cilat TLAS-si ka ofruar shërbim ligjor për personat e kthyer. Duke qenë se procesi i regjistrimit të fëmijëve zgjat në kohë sepse nevojitet të vërtetohet amësia nga rezultati i analizës së ADN-së, 28 (njëzet e tetë) prej çështjeve vazhdojnë të jenë në proces ndërsa 9 (nëntë) të tjera janë të përfunduara me sukses. 2 (dy) nga çështjet kanë të bëjnë me regjistrimin e fëmijëve të kthyer në fazën e parë të riadhesimit.

Përfituesit gjatë proceseve gjyqësore kanë si përfaqësues të tyre avokatët mbështetës të TLAS si dhe marrin asistencë ligjore familjare të vazhdueshme.

QKEDH ka koordinuar dhe realizuar takime onsite dhe online me PMF-të pranë Bashkisë Tiranë, të cilët janë angazhuar në menaxhimin rasteve si dhe në monitorimin e procesit që po realizohet.

Si rezultat i bashkëpunimit me PMF-të e NJA respektive, QKEDH ka organizuar 3-(tre) takime individuale me shtetasit e riadhesuara nga ish vendet e konfliktit Siri dhe Irak ku morën pjesë edhe përfaqësues të TLAS, DA të Policisë së Shtetit, ku shtetasit në fjalë u njohën me procesin ligjor që po zhvillohet si dhe me detyrimet që ato kanë.

3. AKTIVITETE INFORMIMI, NDËRGJEGJËSIMI DHE RITJIA E KAPACITETEVE

Në përmbushje të detyrimeve që rrjedhin nga zbatimi i Strategjinë Ndërsektoriale për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Luftën kundër Terrorizmit 2023–2025, gjatë 6-mujorit të parë të vitit 2023, QKEDH ka vijuar me misionin e saj për forcimin e qëndresës në komunitetin dhe zvogëlimin e tërheqjes ndaj radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm, nëpërmjet aktiviteteve ndërgjegjësuere të opinionit publik dhe rritjes së kapaciteteve, si dhe ndërgjegjësimit të mëtejshëm të punonjësve të vijës së parë të sektorëve të ndryshëm shtetërorë të institucioneve civile dhe atyre të sigurisë, të të rinjve, grave, shoqërisë civile dhe aktorëve të tjerë relevantë të shoqërisë.

Përsa i takon bashkëpunimit të ngritur tashmë me Rektoratet e Universiteteve në vend, QKEDH së bashku me Institutin Shqiptar për Studime Ndërkombëtare(AIIS)⁶ ka organizuar tre forume informuese-ndërgjegjësuere me studentët dhe pedagogët e universiteteve, konkretisht “Aleksandër Xhuvani” Elbasan, Universiteti “Fan S. Noli”, Korçë dhe “Aleksandër Moisiu”, Durrës duke

⁶Këto aktivitete po zhvillohen në vazhdimësi, në kuadër të projektit “Universitetet- Fronti i ri i angazhimit P/ KEDH” me mbështetjen e Ambasadës Amerikane në Shqipëri.

synuar përfshirjen e universiteteve në përpjekje për të luftuar ekstremizmin e dhunshëm nëpërmjet përfshirjes së tematika ekstrakurrikulare përgjatë vitit akademik. QKEDH ka zyrtarizuar marrëveshjen e bashkëpunimit me universitetin “Fan S. Noli”, Korçë⁷ ndërsa vijon të jetë në proces nënshkrimi i Marrëveshjes⁸ së Bashkëpunimit mes QKEDH-së dhe Universitetit “A. Xhuvani” Elbasan.

Në kuadër të zgjerimit të bashkëpunimit me universitetet, QKEDH zhvilloi takim me Dekanin e Fakultetit të Drejtësisë, mbi mundësinë e rekrutimit të studentëve ekselentë të degës së Kriminologjisë pranë QKEDH dhe bashkëpunimin e mëtejshme me Qendrën e Kriminologjisë që do të ngrihet pranë këtij fakulteti. Ne vazhdim të bashkëpunimi, QKEDH ka përgatitur dhe përcjellë pranë Ministri të Brendshëm draft-marrëveshjen e bashkëpunimit midis QKEDH-së dhe këtij universiteti.

Gjithashtu, në përmbushje të misionit të qendrës mbi ndërgjegjësimin dhe rritjen e kapaciteteve në parandalimin dhe kundërshtimin e fenomenit të ekstremizmit të dhunshëm, QKEDH ka marrë pjesë me kontribute aktive në dy sesione informuese, konkretisht leksioni i hapur i zhvilluar me studentët e Universitetit “Luarasi” dhe Universitetit “Beder”.

QKEDH vazhdon ti japë një vëmendje të veçantë rritjes së kapaciteteve të punonjësve të qendrës, me qëllim përmbushjen e misionit të saj, duke marrë pjesë në 6 (gjashtë) trajnime për rritjen e kapaciteteve të punonjësve të saj. QKEDH ka marrë pjesë në 4 (katër) webinarë të organizuara nga Shkolla Shqiptare e Administratës Publike, konkretisht me temë: “Menaxhim Risku”, “Parandalimi i pastrimit të parave si një nga kërkesat e ACQUIS të BE-së”, “Komunikimi Strategjik dhe Marrëdhënie me Publikun” dhe “Përpunimi tekniko-shkencor i dokumentacionit”; trajnimin e organizuar nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, në bashkëpunim me Projektin "Instrumenti Horizontal për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë ", faza III, i bashkë financuar nga Bashkimi Evropian dhe Këshilli i Evropës⁹; si dhe ishte pjesë e trajnimit të mbajtur nga AKSHI. Fokusi i këtij trajnimi ishte mbi ngritjen e kapaciteteve të stafit të QKEDH -së në fushën e Teknologjisë së Informacionit.¹⁰

QKEDH ka realizuar 74 (shtatëdhjetë e katër) takime/ tryeza pune me palë të treta dhe trajnime/workshop-e në kuadër të rritjes së kapaciteteve të aktorëve të vijës së parë ku morën pjesë 1290 (njëmijë e dyqind e nëntëdhjetë) persona.

⁷Në datën 11.05.2023, u nënshkrua marrëveshja e bashkëpunimit midis QKEDH dhe Universitetit “Fan S. Noli”, me qëllim realizimin e veprimtarisë së përbashkët dhe të koordinuar për respektimin, forcimin dhe avancimin e mbrojtjes së të drejtave themelore të njeriut, për menaxhimin e procesit të rikthimit shtetasve shqiptarë nga ish vendet e konfliktit, angazhimin institucional të të gjithë aktorëve shtetërorë të përfshirë në këtë proces, si dhe sfidat e hasura në këtë drejtim.

⁸Procesi ka nisur në Maj 2023, është përcjellë drafti i marrëveshjes pranë Ministrit të Brendshëm.

⁹ Tema e këtij trajnimi ishte funksionimi, roli dhe detyrat e Autoritetit Përgjegjës për parandalimin e konfliktit të interesave, në përdorimin e sistemit elektronik EACIDS.

¹⁰ Gjithashtu gjatë trajnimit u theksuan rregullat që duhet të mbahen parasysht nga çdo përdorues në rrjetin e administratës publike në lidhje me cyber-security.

Me qëllim nxitjen e bashkëpunimit të vazhdueshëm dhe shkëmbimin e njohurive mbi praktikat R&R midis aktorëve të vijës së parë në nivel vendor, QKEDH koordinoi me organizatën Observatori për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve 3(tre) takime rrjetëzuese me aktorët lokal dhe përfaqësues të vijës së parë¹¹, mbi trajtimin e rasteve që lidhen me çështjet e sigurisë në komunitet dhe ofrimin e shërbimeve të ri-integrimit dhe rehabilitimit për personat e kthyer nga Siria, si dhe shkëmbimi i eksperiencës me Kosovën¹².

QKEDH vazhdon aktivitetin koordinues për ngritjen e kapaciteteve të punonjësve të vijës së parë, në bashkëpunim me IDM dhe Urdhrin e Psikologut në Republikën e Shqipërisë u zhvillua trajnimi i psikologëve të vendit mbi temën “Identifikimi, trajtimi dhe parandalimi i radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm në institucionet arsimore të sistemit parauniversitar”¹³. Trajnimi kishte qëllim ngritjen e kapaciteteve të psikologëve në procesin e identifikimit, trajtimit dhe parandalimit të radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm.

Me qëllim riintegrimin dhe risocializimin e të kthyerve nga ish zonat e konfliktit në komunitetet ku janë vendosur, QKEDH dhe organizata LKGV organizuan dy workshope me temë: “Workshop me Gratë e Komunitetit mbi Zhvillimin e Fëmijëve”¹⁴ dhe “Angazhimi Qytetar i Grave dhe Vajzave”¹⁵, me pjesëmarrjen e grave të komunitetit dhe të dy prej të riatdhesuarave të vendosura në njësitë administrative ku u zhvilluan këto workshop-e.

Në kuadër të bashkëpunimit me palët e treta, me qëllim ndërgjegjësimin e komuniteteve, QKEDH koordinoi me organizatën LKGV për zhvillimin 4 (katër) workshop-e me temë “Lufta kundër ekstremizmit të dhunshëm dhe integrimi i të rikthyerve në komunitet”, të cilat u zhvilluan në qytetet: Pogradec, Elbasan, Vlorë, Shkodër, Librazhd dhe Bulqizë. Fokusi kryesor i këtyre workshop-eve është ndërgjegjësimi për fenomenin e ekstremizmit të dhunshëm dhe pranimi i individëve të kthyer në komunitetet ku janë vendosur, sensibilizimi i pjesëtarëve të komunitetit mbi rëndësinë që ka përfshirja e të rikthyerve në komunitet, veçanërisht e fëmijëve, si dhe gjenerimi i alternativave nga komuniteti për lehtësimin e përfshirjes së kësaj kategori shtetasish.

Përgjatë periudhës raportuese, QKEDH në bashkëpunim IDM zhvilluan trajnimin me temë “Raportimi mediatik etik mbi ekstremizmin e dhunshëm, terrorizmin dhe personat e kthyer nga

¹¹ Këto takime u zhvilluan në bashkitë: Tiranë, Mat dhe Pogradec në kuadër të programit “**Ri-integrimi i qëndrueshëm në komunitet i shtetasve të kthyer nga Siria**” i cili po zbatohet në

¹² Në këtë takim morën pjesë përfaqësues nga bashkitë, njësitë administrative, institucionet arsimore dhe shëndetësore, policia, zyrat e punës, përfaqësues të komuniteteve fetare dhe ato të shoqërisë civile.

¹³ Ky trajnim do të zhvillohet në 6 data të ndryshme, me qëllim përfshirjen sa më të gjerë të specialistëve të kësaj fushe.

¹⁴ Qëllimi i këtij takimi ishte mbi rolin e prindit për zhvillimin konjitiv, emocional dhe social të fëmijëve, si dhe faktorët gjenetik dhe mjedisor që ndikojnë në zhvillimin e fëmijëve

¹⁵ Objektivi i përgjithshëm i këtij aktiviteti ishte të ndihmojë gratë dhe vajzat të ushtrojnë të drejtat e tyre, të zhvillojnë aftësi udhëheqëse dhe të promovojnë ndryshime sociale, gjithashtu t'u mundësojë atyre të adresojnë çështjet dhe sfidat që prekin komunitetet e tyre dhe të kontribuojnë në një shoqëri më gjithëpërfshirëse dhe të barabartë

zonat e konfliktit”, i cili kishte synim të informojë dhe ndërgjegjësojë gazetarët mbi raportimin mediatik etik për sa i përket çështjeve që lidhen me terrorizmin, ekstremizmin e dhunshëm dhe personat që kthehen nga zonat e konfliktit¹⁶.

Në kuadër të ndërgjegjësimit të komuniteteve, QKEDH mori pjesë në aktivitetin e organizuar nga WCDC mbi nismën e Këshillit të Grave Yzberisht¹⁷, mbi format e diskriminimit të grave me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit dhe njohjen me kuadrin ligjorë të llojeve të diskriminimit, si një nga faktorët që mund të çojnë në shfaqjen e ekstremizmit të dhunshëm, dhe parandalimin e tyre. Gjithashtu, QKEDH ka kontribuar në simpoziumin me temë “Promovimi dhe fuqizimi i gruas rurale në sipërmarrje dhe krijimi i urave të bashkëpunimit me institucionet publike dhe private” konkretisht për zonat e Leshnicës dhe Bucimasit organizuar WCDCA¹⁸.

QKEDH ka marrë pjesë në tre workshop-e rajonale për zhvillimin e kapaciteteve të praktikuesve të vijës së parë me temë: “Adresimi i shpërndarjes së përmbajtjeve terroriste në internet në Ballkanin Perëndimor”, “Përballja me radikalizimin në shkollë” dhe “Komunikimi strategjik” zhvilluar nga EU RAN për Ballkanin Perëndimor.

Qendra e Koordinimit kundër Ekstremizmit të Dhunshëm në bashkëpunim me Terre des Hommes koordinuan dhe zhvilluan workshop-in konsultativ me pjesëmarrjen e pikave të kontaktit në institucionet qendrore dhe vendore përgjegjëse për raportimin mbi implementimin e Strategjisë Ndërsektoriale për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm 2023-2025.

Gjatë 6-mujorit të parë të vitit 2023, QKEDH ka vijuar me zhvillimin e aktiviteteve në fushën e edukimit dhe në përmbushje të këtij objekti. Ky aktivitet ka qenë i koordinuar edhe me institucione të përfshira në çështjet e P/KEDH dhe OSHC.

Një vëmendje të veçantë QKEDH i jep edhe ndërgjegjësimit dhe të rritjes së kapaciteteve të nxënësve të shkollave të mesme në vendin tonë për fenomenin e radikalizimit dhe ekstremizmit të

¹⁶ Në këtë trajnim morën pjesë gazetarë profesionist dhe të rinj nga mediat kombëtare dhe lokale (të shkruara, elektronike, në internet), si dhe studentë të gazetarisë që janë duke kryer studimet pasuniversitare.

¹⁷ Këto aktivitete po zhvillohen në kuadër të programit “Riintegrimi i qëndrueshëm në komunitet i shtetasve shqiptarë të kthyer nga Siria”, program që po zbatohet në Shqipëri nga IDM në bashkëpunim me Observatorin për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve dhe CDCA nën koordinimin kombëtar të QKEDH, me mbështetjen e Fondit Global të Angazhimit dhe Qëndrueshmërisë së Komunitetit (GCERF). Në këtë aktivitet morën pjesë lider të komunitetit, qytetarë të Yzberishtit, përfaqësues të institucioneve të pavarura publike, organizatave të shoqërisë civile, sociologë, psikologë, punonjës të policimit në komunitet.

¹⁸ Këto aktivitete po zhvillohen në kuadër të programit “Riintegrimi i qëndrueshëm në komunitet i shtetasve shqiptarë të kthyer nga Siria”, program që po zbatohet në Shqipëri nga IDM në bashkëpunim me Observatorin për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve dhe WCDCA nën koordinimin kombëtar të QKEDH, me mbështetjen e Fondit Global të Angazhimit dhe Qëndrueshmërisë së Komunitetit (GCERF)

dhunshëm. Gjatë kësaj periudhe raportuese, QKEDH në bashkëpunim me organizatën LKGV¹⁹ mori pjesë në 6 (gjashtë) workshope me temë “ Lufta kundër ekstremizmit të dhunshëm” me të rinjtë e qytetit të Pogradecit, Elbasanit, Vlorës, Shkodrës, Tiranës, Librazhdit dhe Bulqizës. Objektivi i përgjithshëm i workshop-eve ishte ndarja e informacionit mbi radikalizimin dhe ekstremizmin e dhunshëm, promovimi i kulturës dhe tolerancës, harmonisë shoqërore dhe fetare si dhe nxitja e ndërgjegjësimit dhe bashkëpunimit ndërmjet të rinjve.

Në zbatim të Planit të Veprimit të Strategjisë së re P/KEDH si dhe vazhdim të nismës “Shkolla si qendër komunitare”, QKEDH në bashkëpunim me organizatë Observatorin për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve ka zhvilluar 18 (tetëmbëdhjetë) aktivitete me të rinjtë e qytetit të Tiranës për promovimin e kësaj nisme.

Drejtori i QKEDH-së mori pjesë dhe dha kontributin e tij në një kurs trajnimi për financimin e terrorizmit, organizuar nga Qendra Globale për Sigurinë Kooperative me mbështetjen e Departamentit të Shtetit të SHBA-ve mbi rëndësinë e forcimit të kapaciteteve kombëtare në luftën kundër financimit të terrorizmit dhe ekstremizmit.

Në koordinim me ekspertët e organizatës IANS, QKEDH ka kontribuar në organizimin e 10-sesioneve jashtëshkollore për fëmijë në kushte të vështira ekonomike për mundësi aftësimi dhe forcimin e reziliencës²⁰.

QKEDH mori pjesë në organizimin e forumit koordinues me përfaqësues të lartë të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, Drejtorisë së Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, DVR Korçë, komunitete fetare dhe shoqërisë civile i cili u pasua me vizita studimore në Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale Drenovë dhe Pojskë.

4. KOMUNIKIMI STRATEGJIK

Në përmbushje të objektivit Komunikimi Strategjik dhe në funksion të transparencës mbi aktivitetin që kryen, QKEDH ka publikuar 21(njëzet e një) materiale informuese mbi këtë aktivitet, të cilat janë publikime në faqen zyrtare WEB²¹, në rrjetin social Twitter²² dhe LinkedIn²³.

¹⁹ Trajnimit u mbështetën nga LKGV nëpërmjet grantit të GCERF nëpërmjet projektit me titull “Rritja e qëndrueshmërisë ndaj ekstremizmit të dhunshëm përmes mbështetjes dhe edukimit”, zbatuar nga Linja e Këshillimit për Gra dhe Vajza, Këshilli Ndërfetar i Shqipërisë, Komiteti Shqiptar i Helsinkit dhe Instituti Adriapol.

²⁰ Këto sesione kanë kombinuar punën teorike përmes klasave të djemve dhe vajzave si dhe sesione praktike, ku fëmijët përmes trajnereve të futbollit janë orientuar në aftësimin përmes sportit

²¹ www.cve.gov.al.

²² <https://twitter.com/CenterCve>.

²³ <https://www.linkedin.com/company/centercve/>

QKEDH dha kontributin e saj nëpërmjet një interviste në televizionin Klan News, gjatë së cilës u përcoll informacion mbi ndërhyrjet e realizuara përgjatë këtyre viteve nga Shteti Shqiptar për identifikimin, parandalimin dhe kundërshtimin e ekstremizmit të dhunshëm, proceset e ri-integrimit të nënave dhe fëmijëve të rikthyer nga zonat e konfliktit, në shkollë dhe komunitet, si dhe sfidat e arritjet e paraqitura gjatë këtyre viteve.

Në përmbushje të objektivit të Komunikimit Strategjik, QKEDH në koordinim me IDM²⁴ draftoi dhe realizoi në spot ndërgjegjësues mbi rëndësinë e kundër-narrativave ndaj ekstremizmit të dhunshëm, mikpritjen e të kthyerve në komunitet dhe promovimin e një mjedisi fetar më të sigurt në komunitet.

QKEDH dha kontributin e saj nëpërmjet një interviste në Televizion Kombëtar Rumun “Strile TV” mbi proceset e Rehabilitim/ Riintegritimit dhe Risocializimit të shtetasve shqiptarë të riatdhesuar nga ish zonat e konflikti Siri-Irak, si dhe mbi situatën e personave të cilët ndodhen ende në këto zona.

5. BASHKËPUNIME ME PARTNERË NË NIVEL KOMBËTAR, RAJONAL DHE NDËRKOMBËTAR

Rëndësi të veçantë Qendra e Koordinimit kundër Ekstremizmit të Dhunshëm i kushton edhe bashkëpunimit me partnerët në nivel kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar. Qendra ka vijuar me zhvillimin e partneriteteve me aktorët vendas, rajonal e ndërkombëtarë që punojnë në këtë fushë.

Në kontekstin e produkteve të arritura si rezultat i bashkëpunimit me partnerë në të gjitha nivelet e tij është kontribuar/realizuar në produkte në formën e materialeve/studimeve, 45(dyzet e pesë) takime/ tryeza pune të përbashkëta të zhvilluara onsite apo online një pjesë e tyre, 5(pesë) forume si dhe 7(shtatë)konferenca/videokonferenca.

Drejtori i QKEDH dhe Zv. Ministria e Brendshme Znj. Kuko, zhvilluan një takim pune në Ministrinë e Brendshme me Këshilltarin e DASH për antiterrorin Z. Dan Guerrero në kuadër të vizitës së punës së tij dy ditore në Shqipëri. Z. Dan Guerrero shoqërohej nga Shefi Politik dhe Ushtarak i Ambasadës së SHBA-ve në Tiranë Z. Tobei Arai. Qëllimi i vizitës ishte diskutimi mbi

²⁴Ky spot do të realizohet në kuadër të programit “Riintegrimi i qëndrueshëm në komunitet i shtetasve shqiptarë të kthyer nga Siria”, i cili po zbatohet në Shqipëri nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim në bashkëpunim me Observatorin për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve dhe ECDCA, nën koordinimin kombëtar të Qendrës së Koordinimit Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm, me mbështetjen e Fondit Global të Angazhimit dhe Qëndrueshmërisë së Komunitetit (GCERF).

thellimin e bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Brendshme dhe strukturave përgjegjëse amerikane për Antiterrorin dhe Ekstremizmin dhe informimi mbi progresin që Ministria e Brendshme dhe QKEDH ka bërë në luftën kundër terrorizmit dhe ekstremizmit si dhe reformat që po ndërmerren në tërësi në institucionet e sigurisë.

Po në kuadër të kësaj vizite, Z. Guerrero dhe Z. Arai zhvilluan një tryezë të rrumbullakët pune pranë Qendrës së Koordinimit Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm ku u diskutua për luftën e përbashkët kundër terrorizmit dhe ekstremizmit.

Në vijim të Planit të Veprimit të QKEDH dhe JAP, Drejtori i QKEDH-së zhvilloi takim me Këshilltarin e ri të Antiterrorit për Evropën Juglindore dhe Azinë, ku morën pjesë dhe përfaqësues të institucionit të Shërbimit të Provës dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve për të diskutuar mbi vijim e bashkëpunimit dhe realizimit të masave të Planit të Përbashkët të Veprimit Kundër Terrorizmit në Ballkanin Perëndimor.

Drejtori i QKEDH mori pjesë në takimin e delegacionit të lartë të ICITAP të Departamentit të Drejtësisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës , bashkë me Zv. Ministrin e Brendshëm Znj. Romina Kuko, ku u diskutua mbi bashkëpunimin e mëtejshëm të institucioneve në fushën e Luftës kundër Terrorizmit dhe Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm.

Në vijim të misionit, drejtori i QKEDH-së, shoqëruar nga Këshilltari Rajonal i Antiterrorit për Shqipërinë, Kosovën, Maqedoninë e Veriut dhe Evropën Juglindore pranë Ambasadës së SHBA-ve në Tiranë, Z. Joseph R. Baldwin si dhe Këshilltari Ligjor të OPDAT në Ambasadën e SHBA-ve në Tiranë, Z. Bledar Bashanoviq zhvilluan takime me Drejtorin e Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, Drejtorin e Drejtorisë së Antiterrorit të Policisë së Shtetit dhe Drejtorin e Kabinetit të DPPSH me qëllimi prezantimin Z. Joseph R. Baldwin si Këshilltari i ri për Antiterrorizmin për Evropën Juglindore pranë Ambasadës së SHBA-ve në Tiranë si dhe angazhimi i OPDAT në luftën e përbashkët kundër terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm.

Përfaqësues të QKEDH morën pjesë në trajnimin e organizuar nga GIZ dhe Ministria e Jashtme Norvegjeze, me temë Harta e Hetimeve Financiare. Fokusi i këtij trajnimi ishte mbi praktikatat më të mira për bashkëpunimin ndër-institucional në hetimin e Pastrimit të Parave.

Në kuadër të bashkëpunimit që QKEDH ka me aktorët e sektorit privat në përmbushje të misionit të saj, QKEDH dhe Fondacioni Vodafone Albania zhvilluan trajnimin me PMF-të e Njësisë Administrative të Tiranës mbi aplikacionin “Bright Sky”. Qëllimi i këtij trajnimi ishte për të diskutuar mbi përdorimin e aplikacionit “Bright Sky”. Në vazhdim të bashkëpunimit me QKEDH, u propozua që në këtë aplikacion të shtohet mundësia për raportime të rasteve të ekstremizmit të dhunshëm.

Në vijim të aktiviteteve, trajnimeve dhe tryezave të rrumbullakëta me aktorët e vijës së parë, për evidentimin dhe trajtimin e fenomenit të radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm në sistemin e burgjeve, në zbatim të strategjisë dhe planit të veprimit për luftën kundër terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm, Drejtori i QKEDH, Z. Denion Meidani i shoqëruar nga Ambasadori i Mbretërisë së Vendeve të Ulëta dhe Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve morën pjesë në tryezën e rrumbullakët të organizuar nga QKEDH dhe IANS, në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale të Drenovës me temë “Ndarja e informacionit gjatë procesit të rehabilitimit dhe përgatitjes për lirim – Rolet institucionale të aktorëve të përfshirë në këto procese”. Në përfundim të aktivitetit, u zhvillua dhe event i inaugurimit të Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale në Pojska, Pogradec, institucion i cili u rinovua totalisht sipas standardeve perëndimore me mbështetjen dhe financimin e Ambasadës së Vendeve të Ulëta në Tiranë, në kuadër të ndihmës që kjo Ambasadë jep në sistemin e burgjeve.

QKEDH mori pjesë në aktivitetin Habi rajonal i Ballkanit perëndimor- Punëtorja përruese, organizuar nga Rrjeti i Qyteteve të Forta (Strong Cities Network) e që u mbajt në Sarajevë, Bosnjë dhe Hercegovinë me mbështetjen e Departamentit të SHBA-ve. Në këtë aktivitet morën pjesë kryetarë bashkish, zyrtarë komunal, praktikues dhe përfaqësues nga qeveritë kombëtare dhe organizatat shumëpalëshe nga Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kosova, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut dhe Serbia të cilët shkëmbyen përvoja dhe ekspertiza në punën lokale për të identifikuar sfidat e përbashkëta dhe për të ideuar mënyrat për tejkalimin e tyre, duke u mbështetur në mësimet e nxjerra nga i gjithë rajoni. Aktiviteti ishte një mundësi për të reflektuar mbi kërcënimet gjithnjë e më të hibridizuara dhe të lokalizuara të ditëve të sotme dhe për të identifikuar boshllëqet dhe nevojat për fuqizimin e përgjigjeve/reagimeve parandaluese të udhëhequra nga qytetet.

QKEDH mori pjesë në konferencën “Sfidat e Sigurisë Kibernetike në Shqipëri” të organizuar nga Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike në bashkëpunim me Prezencën e OSBE-së në Shqipëri, USAID/DAI, AKSHI, Shoqatën Shqiptare të Bankave, Soft & Solution, R&T Group, One Telecommunications dhe DigitALB. Qëllimi i konferencës ishte rritja e nivelit të sigurisë kibernetike në vend në zbatim të Planit të ri Strategjik për sigurinë kibernetike, nëpërmjet adresimit të sfidave aktuale të sigurisë kibernetike, si dhe forcimi i bashkëpunimit me partnerët dhe bashkëpunëtorët strategjikë, duke konsideruar edhe kontributin e çmuar të ekspertëve të fushës nga Diaspora.

Në kuadër të bashkëpunimit me palët e treta, QKEDH mori pjesë në prezantimin e Raportit Kombëtar për Sigurinë në Internet për Fëmijët, organizuar nga iSIGURT.al – Platforma Kombëtare për Internet të Sigurt në Shqipëri dhe Linja Kombëtare për Internet të Sigurt për Fëmijët.

Drejtori i QKEDH, Z. Denion Meidani ishte i ftuar në konferencën e organizuar nga Komuniteti mysliman i Shqipërisë në bashkëpunim me Ambasadën e Shteteve të Bashkuara në Shqipëri me temë “Qëndrueshmëria e komunitetit: Sfidat dhe rekomandimet për rritjen e fuqizimit dhe angazhimit të rinjve në komunitet”. Z. Meidani bashkë me Zëvendës ambasadorin e SHBA në Tiranë, Z. Demian Smith, Zv. Ministër i Brendshëm Znj. Romina Kuko, Kreun e Komitetit Mysliman Shqiptar, Z. Bujar Spahiu dhe Drejtorin e Komitetit Shtetëror të Kulteve ndan një paraqitje të shkurtër mbi zhvillimin e ekstremizmit të dhunshëm si fenomen në vendin tonë, masat e ndërmarra kundër tij dhe aktualitetin e sotëm.

Në vijim të bashkëpunimit që QKEDH ka me institucionet partnere ndërkombëtare në kuadër të parandalimit dhe kundërshtimit të radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm, Drejtori i QKEDH-së mori pjesë në Seminarin e nivelit të lartë organizuar nga Drejtoria e Përgjithshme “Ekzekutimi i Dënimeve” të Ministrisë së Drejtësisë së Republikës së Bullgarisë, në bashkëpunim me Projektin HOPE – “Holistic Radicalisation Prevention Initiative, Innovative Prison Systems (IPS)” dhe Kolegjit Universitar të Shërbimeve Korrektuese Norvegjeze, në Sofje, Bullgari. Qëllimi i këtij seminari ishte rritja e vëmendjes së përfaqësuesve të nivelit të lartë ndaj programit të trajnimit dhe strategjisë që po zhvillon projekti HOPE, duke mundësuar diskutimin dhe hartimin e rekomandimeve dhe politikave për luftën kundër Ekstremizmit të Dhunshëm.

QKEDH mori pjesë në takimin rajonal “Përmirësimi i kontributeve kombëtare në Raportin e Situatës dhe Trendit të Europolit (TESAT)” të zhvilluar në Hagë, Holandë. Ky aktivitet u organizua nga GIZ në bashkëpunim me Europol, mbi raportimin e vendeve të Ballkanit Perëndimor për raportin EU Terrorism Situation & Trend Report (TE-SAT).

QKEDH mori pjesë në aktivitetin e zhvilluar nga KE: Instrumenti Horizontal III: Rritja e bashkëpunimit në Ballkani Perëndimor për menaxhimin e ekstremizmit të dhunshëm në burgje dhe parandalimin e radikalizimit të mëtejshëm pas lirimit. Ky projekt do të vazhdojë të promovojë dhe përforcojë bashkëpunimin horizontal rajonal, rrjetëzimin profesional, shkëmbimin e informacionit dhe të lehtësojë rritjen e shkathtësive dhe njohurive midis sistemeve penitenciare dhe palëve të tjera të interesit të rajonit të Ballkanit Perëndimor, duke u ofruar atyre ekspertizën e nevojshme për të adresuar radikalizmin strategjik dhe ekstremizmin e dhunshëm në burgje dhe sfida të tjera të lidhura me to.

QKEDH ka zhvilluar takim me përfaqësues të AKSHI, ekspertë ligjor, ekspert IT dhe organizatës IOM, për finalizimin e diskutimeve mbi zhvillimin e sistemit ICRS për database-in e hedhjes së të dhënave në mënyrë elektronike të dosjeve fizike aktuale mbi menaxhimin e rastit. Në këtë takim u vendos fillimi i procedurave të finalizimit të programit. IOM do të fillojë me procedurat administrative të prokurimeve të nevojshme për pjesët hardware ndërsa programuesit do të fillojnë ndërtimin e software bazuar mbi pyetësin final të dakordësuar nga QKEDH, IOM dhe ICRS Team.

Në përmbushje të misionit të saj, QKEDH u bë pjesë e rrjetit të grave të ngritur me mbështetjen e OSCE, si dhe mori pjesë në takimin e parë të zhvilluar online “ Rrjeti për Gratë Profesioniste në Parandalimin dhe Kundërshtimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Radikalizmit që çojnë në Terrorizëm (P/ CVERLT) në Evropën Juglindore”. Në periudhën raportuese janë zhvilluar 5 takime online ku janë ndanë praktikat mbi fushën P/ CVERT

QKEDH zhvilloi takim me përfaqësues të Ambasadës Holandeze në Shqipëri në kuadër të projekteve që QKEDH ka me Ambasadën e Holandës dhe zgjerimit të tyre në fushën e P/ CVE.

QKEDH koordinoi dhe kontribuoi në trajnimin e organizuar nga IANS “Roli parandalues i Punonjësit të policimit në komunitet në qasjen P/CVE“. Elementët kryesorë të diskutuar në takim ishin: “Koordinimi i qasjeve penale dhe komunitare në parandalim & bashkëpunimi ndërsektorial; Roli i Policisë së Shtetit në parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Përdorimi i instrumentave të vlerësimit të rrezikut” dhe “Menaxhimi i informacionit për ciklin e plotë të personit në konflikt me ligjin. Konsideratat për të drejtat e njeriut, roli i aktorëve në qasjet komunitare”.

QKEDH zhvilloi një takim me përfaqësues të organizatës HEDAYAH ku u diskutua mbi mbështetjen që duan të japin për proceset RRR dhe luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm.

QKEDH mori pjesë dhe kontribuoi në takimin Takim Reflektues të organizuar nga organizata TdH me psikologët shkollor që kanë qenë pjesë e programit të ngritjes së kapaciteteve dhe kanë përfituar nga trajnimet që ka zhvilluar TdH-ja, përfaqësues nga shërbimi psiko-social i Drejtorisë Arsimore Rajonale Tiranë dhe përfaqësues të TdH. Qëllimi i këtij takimi ishte diskutimi mes profesionistësh mbi ecurinë e procesit të riintegritimit të fëmijëve të kthyer nga ish zonat e konfliktit dhe sfidat e rehabilitimit për rastet e kthyer nga zonat e konfliktit.

Në kuadër të bashkëpunimeve me partnerë në nivel kombëtar, QKEDH zhvilloi takim me përfaqësues të Qendrës “Nisma Ligjore dhe Qytetare” (QNLO) ku u diskutua mbi mundësitë e bashkëpunimeve në fushën P/CVE dhe mundësive për ofrimin e ndihmës ligjore falas për shtetasit e rikthyer nga zonat e konflikti Siri-Irak.

QKEDH mori pjesë në workshop-in me temë “Albanian Dissemination” organizuar nga HOPE (Holistic Radicalisation Prevention Initiative) në të cilin QKEDH kontribuoi nëpërmjet një prezantimi mbi mënyrat se si mund të parandalohet ekstremizmi i dhunshëm në kontekstin e burgjeve.

Qendra e Koordinimit Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm mori pjesë në takimet e zhvilluara në Budva- Mal i Zi, konkretisht, në: Takimin e radhës së Rrjetit Rajonal të Koordinatorëve Kombëtar CT-P/CVE (RNNC) të Ballkanit Perëndimor; Takimin e Grupit Mbështetës Rajonal IISG për

Shtyllën 1- Nisma e Ballkanit Perëndimor Kundër Terrorizmit (WBCTi) dhe takimi e organizuar nga IOM në kuadër të projektit “Ndërtimi i Kapaciteteve institucionale në Ballkanin Perëndimor”, për tu marrë me sfidat që lidhen me risocializimin e riintegrimin dhe rehabilitimin e luftëtarëve të huaj terroristë (RFTF) dhe familjeve të tyre, të kthyer nga zonat e konfliktit”.

Në kuadër të bashkëpunimeve me palë të treta, QKEDH zhvilloi një takim me përfaqësues të BI HUB UNOCT (Behavioural Insight International Hub (BI Hub)), e cila është pjesë e programit të UNOCT në Doha, Katar. Në këtë takim u diskutuan sfidat dhe arritjet e Qendrës Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm, si edhe bashkëpunimin e mundshëm me BI Hub. Gjithashtu në këtë takim u diskutua mundësia e organizimit të një workshop-in gjatë muajit qershor, mbi zbatimin e njohurive të sjelljes për ndërtimin e qëndrueshmërisë së komunitetit ndaj radikalizimit dhe riintegrimin efektiv si dhe eksplorimit me qasje inovatore që mbështeten në parimet e provuara të shkencave sociale.

Në vijim të bashkëpunimit frytdhënëse që QKEDH ka me institucionet partnere ndërkombëtare për parandalimin dhe kundërshtimin e radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm, mori pjesë në vizitën studimore në Kristiansand të Norvegjisë, në kuadër të javës së Demokracisë, e organizuar nga organizata Projekte Vullnetare Ndërkombëtare (PVN/Albania). Qëllimi i kësaj vizite studimore ishte të kuptuarit e modelit Norvegjez në parandalimin e radikalizimit dhe kriminalitetit si dhe krijimi i bashkëpunimeve me aktorët kyç në fushat me interes nga e gjithë Europa.

QKEDH mori pjesë në takimin e parë të Komitetit Drejtues, organizuar nga KE në kuadër të programit “Mbështetje Horizontale për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë”, i cili u mbajt në Podgoricë, Mali i Zi. Qëllimi i këtij takimi ishte rritja e bashkëpunimit në Ballkanin Perëndimor për menaxhimin e ekstremizmit të dhunshëm në burgje dhe parandalimin e mëtejshëm të radikalizimit mbas lirimimit si dhe të një takimi me partnerët ndërkombëtar.

QKEDH mori pjesë në seminarin e zhvilluar në Kenia, në cilësinë e Anëtarit të “Country Support Mechanism Team” të organizuar nga GCERF, Qëllimi i këtij seminary ishte diskutimi dhe shqyrtimi i gjetjeve të një vlerësimi të kryer për të përmirësuar të kuptuarit e Sekretariatit, si dhe përcaktimi i pikave e forta dhe të dobëta të mekanizmit koordinues të GCERF mbi hartimin e strategjisë dhe planit të veprimit për mirëfunksionimin e MKT.

QKEDH mori pjesë në vizitën studimore të mbajtur në Kosovë nga Iniciativa Atlantike në bashkëpunim me GCERF në kuadër të projektit “Forcimi i komunikimit strategjik dhe Kapaciteteve Profesionale për Menaxhimin e procesit të rehabilitimit dhe riintegrimin në Bosnje-Hercegovinë”. Qëllimi i kësaj vizite ishte për të ndihmuar ekspertët e institucioneve të Bosnje-Hercegovinës për tu njohur me praktikat e ndjekura nga shteti i Kosovës në ndjekjen e procesit e

riatdhesimit, rehabilitimit dhe integritit të të kthyerve nga ish zonat e konflikti. Përfaqësuesit e QKEDH ndanë me partnerët e tjerë rajonalë eksperiencën e shtetit shqiptar mbi këto procese.

QKEDH mori pjesë në “Takimin Ndërkombëtar për Riatdhesimin e Luftëtarëve të Huaj Terroristë dhe Personave të zhvendosur nga Siria Verilindore” organizuar nga Instituti Ndërkombëtar për Drejtësi dhe Sundim të Ligjit në bashkëpunim me Departamentin Amerikan të Shtetit të i cili u mbajt në Maltë. Në këtë takim, QKEDH ndau eksperiencën e Shqipërisë në proceset R&R&R si dhe në hapat që ndjek vendi ynë në ndjekjen penale të të riatdhesuarve.

Në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar në luftën kundër terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm, dhe në vazhdim të partneritetit që Shqipëria dhe Shtetet e Bashkuara kanë zhvilluar në këtë fushë, një delegacion i nivelit të lartë të Departamentit të Shtetit i cili kryesohej nga Z. Sam Pineda, Drejtor i Zyrës së Programeve në Byronë e Antiterrorit në Departamentin Amerikan të Shtetit zhvilluan një vizitë pune pranë Ministrisë së Brendshme (MB). Fokusi i takimit ishte rritja e bashkëpunimit dy palësh mes QKEDH dhe Byrosë së Antiterrorit të Departamentit të Shtetit në luftën e përbashkët kundër terrorizmit dhe ekstremizmit si dhe mbështetja amerikane në proceset R&R dhe ato të transformimit të QKEDH në Agjenci Kundër Terrorizmit dhe Ekstremizmit.

Drejtori i QKEDH-së ishte i ftuar nga Fondit Global i Angazhimit dhe Qëndrueshmërisë të Komunitetit (GCERF) për të marrë pjesë në takimin e 18-të të Bordit të GCERF që u organizua në Tunis, Tunizi. Gjatë kësaj vizite, përveç mbledhjes së Bordit, u realizuan dhe vizita në terren ku u vizituan programet e financuara nga GCERF që dëshmojnë drejtpërdrejtë ndikimin që grantet e GCERF kanë tek ata që janë të cenueshëm ndaj ekstremizmit të dhunshëm.

QKEDH mori pjesë në aktivitetin rajonal të STRONG CITIES NETWORK me temë “Qasje të udhëhequra nga qytetet për fuqizimin e të rinjve për adresimin e ekstremizmit, urrejtjes dhe polarizimit”, Në këtë aktivitet u bë vlerësimi i qasjeve gjithë-shoqërore të udhëhequra nga qytetet për fuqizimin e të rinjve për adresimin e kërcënimeve ndaj sigurisë lokale, duke përfshirë angazhimin dhe kontributin përmes mekanizmave lokal për parandalim me shumë aktorë.

QKEDH koordinoi me Institutin për Demokraci dhe Meditim për zhvillimin e trajnimeve të psikologëve mbi temën “Identifikimi, trajtimi dhe parandalimi i radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm në institucionet arsimore të sistemit parauniversitar” me qellim përfshirjen sa më të gjerë të aktorëve të vijës së parë në shkolla.

Në kuadër të MKT së GCERF, QKEDH mori pjesë në takimin online me anëtarët e këtij mekanizmi ku u adresuan disa tematike si: pasqyrimi i mënyrës si është adresuar feedback-u në TSM mbi propozimet dhe aktivitetet e organizatave LKGV dhe TdH, si dhe propozimi i TdH i

shoqëruar me përgjigjet për komentet nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me titull “Feedback për MSHMS”.

QKEDH mori pjesë në konferencën përmblylëse të projektit EUTEX me temë: “Avancimi i shkëputjes dhe riintegrimi i të dënuarve ekstremistë dhe terroristë”. Në këtë konferencë ishte pjesëmarrëse edhe Ministria e Drejtësisë së Austrisë, e cila falënderoi projektin për punën e bërë në luftimin e ekstremizmit dhe terrorizmit në burgje në Evropë dhe vendet e Ballkanit.

QKEDH mori pjesë në Workshop-in Final Rajonal të mbajtur nga Young Womans’ Christian Association of Albania në kuadër të projektit “Fuqizimi i rrjeteve lokale të grave për të parandaluar ekstremizmin e dhunshëm, si një mekanizëm për të krijuar komunitete vigjilente dhe të bashkuara”²⁵. Synimi kryesor i aktivitetit është identifikimi i praktikave pozitive dhe krijimi i një grupi të qëndrueshëm që do të vazhdojë të promovojë rolin e vajzave dhe grave për të qenë aktore kryesore në parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm.

Në kuadër të bashkëpunimit me organizatat partnere ndërkombëtare për përmbushjen e misionit të riintegritimit dhe risocializimit të personave kthyer nga ish zonat e konfliktit, drejtori i QKEDH, z. Denion Meidani i shoqëruar nga ambasadori i UNICEF në Shqipëri, z. Roberto De Bernardi zhvilloi një vizitë në qendrën e pritjes së fëmijëve “One-Stop Shop” në qytetin e Fierit dhe në Dhomën Miqësore për intervistimin e Fëmijëve për Policinë e Shtetit në qytetin e Gjirokastrës për fëmijët e pa shoqëruar apo në konflikt me ligjin. Gjatë vizitës në drejtorinë vendore të Policisë Gjirokastrë, Drejtori, z. Ardian Cipa prezantoi ambiente e intervistimit të fëmijëve dhe falënderoi UNICEF për mbështetjen e dhënë në ngritjen e sajë.

QKEDH në bashkëpunimin me KE zhvilluan konferencën rajonale me temë “Sfidat për sigurimin e vazhdimësisë së daljes nga burgu të të burgosurve ekstremistë të dhunshëm (VEP) dhe të burgosurve të tjerë të cenusur dhe të marginalizuar në rrezik nga radikalizimi në Ballkanin Perëndimor” mbajtur në qytetin e Durrësit në kuadër të projektit “Mbështetja horizontale për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë”. Në këtë konferencë z. Meidani falënderoi Këshillin e Evropës për punën e bërë në Shqipëri, por edhe në të gjithë rajonin për luftimin e radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm në një ambient delikat siç janë Institucionet e Ekzekutimeve të Vendimeve Penale”.

QKEDH ishte pjesë e takimit të mbajtur në Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave në kuadër të Vlerësimit Kombëtar të Riskut për pastrimin e parave dhe financimin e

²⁵ Ky aktivitet u mbështet nga Zyra e Marrëdhënieve me Publikun pranë Ambasadës Amerikane në Shqipëri. Në këtë aktivitet morën pjesë, rrjetet lokale të grave si dhe përfaqësues të strukturave të ndryshme, ndanë përvojat e tyre mbi parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm sipas qasjes gjinore

terrorizmit zhvilluar. Çështjet që u diskutuan në këtë takim ishin metodologjia që po aplikohet dhe ecuria e deritanishme e këtij dokumenti; të dhënat e mbledhura dhe vështirësitë e hasura si dhe kontributet e ardhshme që priten për pjesën takuese të secilit institucion.

Drejtori i QKEDH, Z. Meidani ka kryesuar një delegacion shqiptar në Belgjikë, me ftesë të z. Roy Boes, Kryeinspektor i Grupit të Kërkimit Digital dhe Analizës pranë Departamentit të Specializuar të Kërkimit (DGO) INTEL, Bruksel, Belgjikë, ku kanë marrë pjesë përfaqësues nga Ministria e Brendshme dhe nga institucionet e tjera ligjzbatuese. Qëllimi i këtij takimi ishte prezantimi i disa temave në lidhje me situatën aktuale në vend mbi; Parandalimi i ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit në nivel lokal; Kundërshtimi i ekstremizmit dhe radikalizmit në nivel lokal; Ndjekja e FTF/Të Kthyerit dhe fëmijët e tyre; Riintegrimi i të kthyerve në shoqëri; VERT dhe analiza e kërcënimit në botën digjitale; Kalimi i inteligjencës digjitale në një hetim digjital; Implikimet lokale të ngjarjeve/incidenteve globale; Hetimi i kërcënimeve ndaj sigurisë publike.

QKEDH ka bërë 4 takime me përfaqësuesit e Bashkisë Tiranë, përkatësisht PMF 3,11,12 dhe 14, në kuadër të procesit të riintegrit. Në takim është diskutuar mbi dinamikën e shkollave profesionale dhe punësimi i rastit A.R i cili po koordinohet edhe me DA.

6. AKTIVITETI RAPORTUES DHE MONITORUES

QKEDH ka realizuar dhe marrë pjesë në një sërë procesesh raportuese në kuadër të raportimit institucional në kontekstin e marrëdhënieve ndër-institucionale të bashkëpunimit me institucionet e tjera shtetërore dhe ato ndërkombëtare.

Në kuadër të përmbushjes së këtij objekti, QKEDH gjatë këtij 6 (gjashtë) muaji, ka marrë në shqyrtim dhe proceduar 303 (treqind e tre) raportime periodike, vlerësuese mbi ecurinë e procesit të rehabilitimit, riintegrit dhe risocializimit të shtetasve shqiptar të kthyer nga ish zonat e konfliktit, me synim informimin mbi ecurinë e rasteve dhe koordinimin për nevojat e identifikuara.

Raportet e shqyrtuara janë 147 (njëqind e dyzet e shtatë) raporte të mësuesve mbështetës për fëmijët, si dhe 156 (njëqind e pesëdhjetë e gjashtë) raporte të psikologëve mbështetës për familjet.

Në kuadër të përmbushjes së objektivit të monitorimit dhe raportimit, specifikojmë disa prej momenteve raportuese institucionale të cilat kanë shënjuar të gjithë veprimtarinë institucionale.

QKEDH ka përcjellë pranë Drejtorisë së Antiterrorit raportin mbi ecurinë e 37 (tridhjetë e shtatë) shtetasve shqiptarë të kthyer nga ish-zonat e konfliktit Siri-Irak, bazuar mbi Planin Individual për secilin rast si dhe ka përcjellë pranë GCERF tabelarin me informacione mbi të gjitha shërbimet mbështetëse që ofrohen për përfituesit nga organizatat partnere në kuadër të projektit “Riintegrimi i qëndrueshëm në komunitet i shtetasve shqiptarë të kthyer nga Siria”, i cili po zbatohet në Shqipëri me mbështetje financiare të GCER.

Në kuadrin e këtij objekti raportohet se QKEDH përcolli pranë Drejtorisë së Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator, në MB, komentet për dy masat që

QKEDH dhe disa institucione janë ngarkuar për zbatimin e projektvendimit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale “Për Miratimin e Planit të Veprimit për zbatimin e Rezolutës 1325 të Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara “Për Gruan, Paqen dhe Sigurinë”, 2023– 2027, në Republikën e Shqipërisë.

Përgjatë muajve janar- qershor 2023 raportohen kontribute nga QKEDH si në vijim:

- ✓ QKEDH mori pjesë dhe kontribuoi në Tryezën Koordinuese për hartimin e draft Udhëzuesit për Shtetin e së Drejtës, organizuar nga Ministria e Brendshme në cilësinë e liderit për Kapitullin 24 në bashkërendim me Ministrinë e Drejtësisë (lider për Kapitullin 23). Ky takim u mbajt në kuadër të vazhdimësisë së punës GNPIE për Kapitullin 24 "Drejtësia, Liria e Siguria", ku u informua se aktualisht jemi në pritje të screening report nga Komisioni Evropian. Duke pasur parasysh intensitetin e këtyre zhvillimeve, në këtë takim u diskutua për koordinimin e punës për hartimin e udhërrëfyesit për Shtetin e së Drejtës ku do të parashikohen me hapa dhe objektiva konkrete veprimet që do të ndërmerren nga shteti shqiptar për përmbushjen e këtyre rekomandimeve.
- ✓ QKEDH ka dërguar kontributin e saj pranë MB, 4-raporte mbi Kapitullin 24, Drejtësia, Liria dhe Siguria.
- ✓ QKEDH ka dërguar kontributin e saj pranë MEPJ , 4-raporte mbi Kapitullin 31, Politika e Jashtme e Sigurisë dhe e Mbrojtjes.
- ✓ QKEDH dërgoi pranë MEPJ-së kontributin për Raportin Tremujor për Kapitullin 31, në kuadër të raportimit tremujor që bëhet për Kuvendin e Shqipërisë për të gjithë ecurinë në kapitujt e acquis, për periudhën prill-qershor 2023.
- ✓ QKEDH ka përpiluar relacionin për miratimin e “Procedurave Standarde Të Veprimit (PSV), për Rehabilitimin dhe Riintegrimin Fillestar të Personave të Kthyer nga Zonat e ish-Konfliktit”.
- ✓ Qendra e Koordinimit kundër Ekstremizmit të Dhunshëm ka përcjellë pranë Drejtorisë së Integritit, Koordinimit, Marrëveshjeve dhe Asistencës në Ministrinë e Brendshme, informacionin mbi draftin e parë për hartimin e objektivave dhe masave mbi radikalizmin dhe ekstremizmin e dhunshëm të Udhërrëfyesit për Shtetin e së Drejtës.
- ✓ QKEDH ka dhënë kontributin e saj për hartimin e Strategjisë së Sigurisë Kombëtare 2023-2028 pranë MEPJ.
- ✓ QKEDH ka bashkëpunuar me Ministrinë e Brendshme mbi hartimin e draftit final për Strategjinë e Sigurisë Kombëtare.
- ✓ QKEDH përcolli pranë Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Brendshme komentet përkatëse, bashkëlidhur me urdhrin dhe relacionin shoqërues për Krijimin e Komitetit Rajonal për kundërshtimin e Ekstremizmit të Dhunshëm.
- ✓ Qendra e Koordinimit kundër Ekstremizmit të Dhunshëm mori pjesë në takimin e 14-të të Nënkomitetit Bashkimi Evropian –Shqipëri, Kapitulli 24 “Drejtësia, Liria dhe Siguria”, mbi zhvillimet e fundit të proceseve të riintegritit të personave të riatdhesuar nga ish-zonat e konfliktit si dhe mbi zbatimin e masave të Planit të Përbashkët të Veprimit kundër Terrorizmit Shqipëri- BE.

- ✓ QKEDH mori pjesë dhe kontribuoi në sesionin e 94-rt të Dialogut Interaktiv të CRC (Komiteti për të Drejtat e Fëmijëve) të zhvilluar online, mbi hartimin e raportit për të drejtat e fëmijëve në Shqipëri.
- ✓ QKEDH përcolli pranë Ministrisë së Brendshme kontributin e saj mbi “Takimi Bilateral-Kapitulli 10”.

Gjithashtu evidentohet se :

- QKEDH ka përcjellë pranë Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Brendshme kërkesën për ndërhyrje institucionale, për caktim të pikave të kontaktit të institucioneve përgjegjëse me urdhër titullari, për raportimin dhe ndjekjen e detyrimeve institucionale, që rrjedhin nga Strategjia Ndërsektoriale për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm (2023-2025).
- QKEDH vijon me plotësimin e dosjeve fizike të shtetasve të riatdhesuar nga Siria dhe Iraku me informacion të përditësuar në kuadër të procesit multidisiplinar të rehabilitimit dhe riintegritimit.

Qendra e Koordinimit kundër Ekstremizmit të Dhunshëm përgjatë periudhës Janar- Qershor 2023, vlerësoi si prioritet të rëndësishme të punës së saj, ndërhyrjet në drejtim të zbatimit të programeve rehabilituese dhe riintegruese që po i ofrohen shtetasve shqiptarë në komunitet si dhe shtetasve të kthyer nga zonat e ish-konfliktit Siri dhe Irak. Po ashtu është punuar për të zbatuar veprimtaritë e planifikuara me një qasje prioritare kundrejt komunikimit strategjik që duhet të ndërmerret në këtë drejtim.

7. PROBLEMATIKA

Përgjatë kësaj periudhe raportimi, QKEDH evidenton si problematika të rëndësishme që kërkojnë vëmendjen e Ministrisë së Brendshme për adresim institucional si më poshtë:

- Rritja e mëtejshme e kapaciteteve profesionale për të gjitha strukturat e kategorizuara në të ashtuquajturën “qasje e butë”, por jo vetëm, që do të angazhohet në riatdhesimin e shtetasve shqiptarë që ndodhen aktualisht në ish zonat e konfliktit, Siri dhe Irak. Të gjitha programet e riintegritimit për këtë kategori, përfshirë gratë/vajzat dhe fëmijët, kërkojnë angazhim të vazhdueshëm dhe afatgjatë të burimeve financiare dhe njerëzore në terren. Aktualisht, këto burime mbeten ende të kufizuara.
- QKEDH në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, Sportit synon të ndërhyjë në kurrikulën bazë arsimore për ta pasuruar atë në kuadrin e njohurive arsimore të përgjithshme të nxënësve shqiptarë duke iu referuar konceptit bazë. Nga ana tjetër, po zhvillohet një proces aktiviteti për krijimin e platformave të edukimit digjital, ku veçanërisht të rinjtë mund të shkëmbejnë ide dhe të ndërtojnë narrativa alternative efektive për t’iu kundërvënë këtij fenomeni, një qasje e cila do të kontribuojë në zhvillimin e të menduarit kritik për çështje të tilla si demokracia, feja, të drejtat dhe liritë e individit etj.

- Dukuria e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit në vendin tonë kërkon një “qasje shumë dimensionale” dhe përfshirjen e të gjithë aktorëve qendrorë dhe vendorë në zbatimin e kuadrit ligjor strategjik në fuqi, me qëllim parandalimin dhe zhvillimin e alternativave të qëndrueshme. Për këtë arsye, është shumë e domosdoshme ndjekja e procedurave respektive për miratimin e urdherit të Kryeministrit “Për krijimin e komitetit rajonal të parandalimit të radikalizmit dhe luftës kundër ekstremizmit të dhunshëm”.
- Duke marrë në konsideratë detyrimet që rrjedhin nga marreveshja “Joint Action Plan on Counter-Terrorism for Eastern Balkans” ndërmjet Shqipërisë dhe Komisionit të EU firmosur nga Ministri Çuçi dhe Komisioneri Johansson më datë 09.12.2022, konkretisht, pika 1.1 (a), pika 1.2 (c), dhe rekomandimet e misionit të “EU Peer Review Mission” i shtatorit 2022, ku Shqipëria merr përsipër zbatimin e rekomandimeve për ngritjen e një sistemi Vlerësimi Kombëtar i Kërcënimeve; zhvillimin e një qasje të strukturuar të “Vlerësimit dhe Analizës së Përbashkët të pavarur të Informacionit”; Krijimi i Qendrës “Fusion Center” të Shkrirjes së Informacionit; “Zhvillimi i një sistemi të përbashkët kombëtar të klasifikimit të kërcënimeve”; QKEDH ka propozuar Ministrisë së Brendshme projekt propozimin për krijimin e “Agjencisë Kundër Terrorizimit dhe Ektremizmit” e parashikuar për tu miratuar në katër mujorin e parë të këtij viti në bazë të VKM 862 datë 27.12.2022 “Për miratimin e programit të përgjithshëm analitik të projektakteve që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave gjatë vitit 2023, edhe përse janë kryer një sërë takimesh për këtë qëllim, akoma mbetemi në pikën fillestare të propozimit nga QKEDH.
- Që prej vitit të kaluar, QKEDH ka konstatuar se institucioni ka mangësi të rëndësishme në librat e inventarit të aseteve, konkretisht të aseteve donacione nga organizata të ndryshme. Për zgjidhjen e këtij shqetësimi, është koordinuar me Drejtorinë e Përgjithshme Ekonomike dhe të Shërbimeve të MB, për të cilën është ngritur një grup pune nën drejtimin e kësaj të fundit për evidentimin, dokumentimin dhe përfundimin e inventarit të aseteve për të cilën, QKEDH vazhdon të jetë në pritje të përmbylljes së saj nga Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike dhe të Shërbimeve pranë MB.

Gjatë periudhës raportuese është theksuar angazhimi i QKEDH, për pasojë raportohen disa nevoja urgjente të cilat duhet të adresohen në periudhën e ardhshme raportuese në nivel kapaciteti institucional dhe veprimi në të gjitha fushat ku operon QKEDH, dhe më konkretisht:

1. Nevojë urgjente për miratimin e propozimit të QKEDH për krijimin e “Agjencisë Kundër Terrorizimit dhe Ektremizmit” dhe rritjen e numrit të punonjësve nisur nga fusha e veprimtarisë dhe përgjegjësisë së QKEDH pasi organika aktuale 1+7 e cila ka sjellë mbingarkesë për të gjithë punonjësit e QKEDH duke kryer më shumë se dy detyra funksionale në të njëjtën kohë.
2. Nevoja urgjente e një mjeti transporti nisur nga angazhimi në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe gjendja aktuale e mjeteve të QKEDH në dispozicion ku nga tre mjete në inventar vetëm një mjet është në gjendje funksionale aktualisht.
3. Nevojë urgjente për ambiente pune (zyra) pasi zyrat aktuale të vendoru përkohësisht pranë Ministrisë së Brendshme, akoma nuk janë me një status të qartë qëndrimi për

- QKEDH dhe që nuk plotëson kushtet e sigurisë së kartotekës dhe kompjuterave për prodhimin e dokumentacionit të klasifikuar.
4. Prioritizim i miratimit të Urdhrit të Kryeministrit për Krijimin e Komitetit Rajonal të Luftës Kundër Radikalizmit dhe Ekstremizmit të Dhunshëm i cili do të shërbejë si mekanizëm kombëtar referimi, pasi një mekanizëm i tillë mungon duke sjellë vështirësi dhe pamundësi të evidentimit të rasteve dhe fenomeneve në kohë me qëllim adresimin e tyre.
 5. Për zbatimin e masave dhe ndjekjen e detyrimeve respektive sipas institucioneve të përfshira në zbatim të “Strategjisë Ndërsektoriale për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm (2023-2025)” dhe planet përkatëse të veprimit, QKEDH ka përcjellë pranë Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Brendshme kërkesën për ndërhyrje institucionale, për caktim të pikave të kontaktit të institucioneve përgjegjëse me urdhër titullari, për raportimin dhe ndjekjen e detyrimeve institucionale për të cilën ende nuk kemi përgjigje.